

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Praktika e Auditimit të
Brendshëm
(zgjidhjet)**

B3

ID Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'JU LEJOHET PREJ MBIKËQYRËSIT
Do Not Open Until Your invigilator Allows You to Do So.
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA PYETJEVE
All Questions Are Mandatory
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË FLETË
TË KËTIJ PROVIMI.
Your name should appear nowhere in this test.

Data 08.02.2025

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

CONTENT/ PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i dhënë	Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK PIKËT E DHËNA
1. Pyetje (50 x 2 pikë)	100	
Gjithsej	100	

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

1. Cili nga faktorët e mëposhtëm shërben si një kontribut i drejtpërdrejtë i buxhetit financiar të departamentit të auditimit të brendshëm?
 - a) Raportet e aktivitetit
 - b) Efektiviteti i kaluar i departamentit të auditimit të brendshëm në identifikimin e kostove të kursimeve
 - c) Statuti i departamentit të auditimit
 - d) Oraret e punës së auditimit**

2. Kur kryen hetime për mashtrim, auditimi i brendshëm duhet të:
 - a) Tregoj qartë shkallën e njohurive të auditimit të brendshëm për mashtrimin kur merren në pyetje të dyshuarit.
 - b) Vlerësoj nivelin e mundshëm dhe shtrirjen e bashkëpunimit të mashtrimit brenda organizatës.**
 - c) Caktoj personel në hetim në përputhje me orarin e auditimit të vendosur në fillim të vitit fiskal.
 - d) Kryej hetimin e tij të pavarur nga, avokatët, personeli i sigurisë dhe specialistët nga jashtë organizatës që janë të përfshirë në hetim.

3. Edhe kur ka shumë evidenca të mashtrimit nga një punonjës i caktuar, auditimi i brendshëm zakonisht nuk do të fillojë një ankesë penale, por do ta lërë këtë veprim për autoritetet e zbatimit të ligjit. Duke vepruar kështu, auditimi i brendshëm shmang mundësinë e të akuzuarit për:
 - a) Burgim të rremë
 - b) Ndjekje penale me qëllim të keq**
 - c) Shpifje
 - d) Përgojim

4. Një drejtor i auditimit të brendshëm ka rishikuar kredencialet, ka kontrolluar referencat, dhe ka intervistuar një kandidat për një pozicion stafi në ekipin e auditimit. Drejtori arrin në përfundimin se kandidati ka njohuri të mira të teknikave të auditimit të brendshëm, kontabilitetit dhe menaxhimit. Sidoqoftë, drejtori vëren se kandidati ka njohuri të kufizuara të ekonomisë dhe shkencave kompjuterike.

Cili nga veprimet e mëposhtme do të ishte më i përshtatshmi?

 - a) Ofroni kandidatit një pozicionin e punës nëse anëtarët e tjerë të personelit kanë njohuri të mjaftueshme në ekonomi dhe shkenca kompjuterike.**
 - b) Refuzoni kandidatin për shkak të mungesës së njohurive të kërkuara nga Standardet e IIA.
 - c) Ofroni kandidatit një pozicion përkundër mungesës së njohurive në fusha të caktuara thelbësore.
 - d) Inkurajoni kandidatin për të marrë trajnim shtesë në ekonomi dhe shkenca kompjuterike dhe më pas ri-aplikoni.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

5. Departamenti i auditimit të brendshëm të një korporate të madhe ka krijuar planin dhe buxhetin e tij operativ për vitin e ardhshëm. Plani i operimit është i kufizuar në këto kategori: një listë me përparësi e të gjitha auditimeve, stafit, një buxhet i detajuar i shpenzimeve dhe data e fillimit të secilit auditim.
- Cila nga opsionet e mëposhtme përshkruan më së miri mungesën kryesore të këtij plani operativ?
- Kërkesat nga menaxhmenti për projekte të veçanta nuk merren parasysh.
 - Mundësitë për të arritur përfitime operative janë injoruar.
 - c) Kriteret e matjes dhe datat e synuara të përfundimit nuk janë dhënë.**
 - Njohuritë, aftësitë dhe disiplinat e kërkuara për të kryer punë janë injoruar.
6. Sipas Standardeve IIA, raportet e aktivitetit të një departamenti të auditimit të brendshëm duhet të:
- Listojnë gjetjet materiale të auditimeve kryesore.
 - Listojnë gjetjet e pazgjidhura.
 - Raportojnë aktivitetet javore të auditorëve individualë.
 - d) Krahasojnë auditimet e përfunduara me auditimet e planifikuara.**
7. Departamenti i auditimit të brendshëm të një korporate të madhe kohët e fundit përfundoi një audit të shpenzimeve të udhëtimit të departamentit të shitjeve.
- Cili nga grupet e mëposhtme duhet të marrë një kopje të raportit të auditimit?
- a) Drejtori i shitjeve dhe zv. drejtori i marketingut.**
 - Kryetari i bordit, zyrtari kryesor operativ dhe zv. drejtori i marketingut.
 - Kryetari i bordit, kontrollori dhe drejtori i shitjeve.
 - Kryeshefi financiar, drejtori i shitjeve dhe drejtori ekzekutiv.
8. Komunikimi i suksesshëm konsultativ në një auditim të brendshëm bazohet pjesërisht në reagimet e të audituarëve për veprimet e auditorëve gjatë auditimit. Ky reagim (feedback):
- Duhet të shkojë vetëm tek menaxhmenti i lartë si një mjet për të rishikuar auditorët.
 - Duhet të shkojë vetëm tek auditorët për t'i ndihmuar ata të përmirësojnë performancën e tyre të auditimit.
 - c) Duhet të shkojë te menaxhmenti dhe auditorët për t' u siguruar që vlera e biznesit po shtohet.**
 - Do të mbrojë të audituarit nga auditorët.
9. Një auditor i brendshëm që dyshon në mashtrim duhet:
- Të përcaktoj që është shkaktuar një humbje.
 - Të intervistoj ata që janë përfshirë në kontrollin e pasurive.
 - Të identifikoj punonjësit që mund të jenë të përfshirë në këtë çështje.
 - d) Të rekomandoj çfarëdo hetimi që konsiderohet i nevojshëm në rrethana.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

10. Një auditor i brendshëm po planifikon një auditim operativ të një qendre kompjuterike. Cila nga pikat e mëposhtme normalisht do të konsiderohej më i rëndësishëm?
- Llogaritja e sasive të kërkuara të disketave, letrave dhe furnizimeve të tjera.
 - Përcaktimi i moshës dhe gjendjes së kompjuterit kryesor.
 - Kryerja e një studimi të shitësve të kompjuterave që do të përdoren në blerjet e ardhshme.
 - d) Konstatimi i ekzistencës së masave adekuate të rezultateve operacionale.**
11. Firma juaj kohët e fundit ka shndërruar ciklin e blerjes nga një proces manual në një sistem kompjuterik në internet. Cila nga sa vijon është një rezultat i mundshëm që lidhet me shndërrimin në sistemin e ri automatik?
- Gabimet e përpunimit janë rritur.
 - Natyra e ekspozimit ndaj rrezikut të firmës është zvogëluar.
 - Koha e përpunimit është rritur.
 - d) Detyrat tradicionale janë më pak të ndara.**
12. Kur përdoret kompjuterin për të përpunur regjistrin kryesor të punonjësve me regjistrin e transaksioneve të pagave (i përbërë nga të dhënat kohore për çdo punëtor prodhimi në orë dhe regjistrimet jashtë orarit për stafin me rrogë), auditori në thelb po teston për:
- Plotësinë e regjistrave të punës jashtë orarit.
 - Arsyeshmërinë e niveleve të pagave të punëtorëve të prodhimit.
 - Arsyeshmërinë e pagave të stafit.
 - d) Ekzistencën e pagesave për punonjësit fiktiv.**
13. Kërkesa që blerjet të bëhen nga furnitorët në një listë të miratuar të furnitorëve është shembull i një:
- a) Kontrolli parandalues**
 - Kontrolli zbulues
 - Kontrolli korigjues
 - Kontrolli të monitorimit
14. Inventari i një ndërmarrje prodhuese përfshin një investim të rëndësishëm në metalet e çmuara. Rishikimi i sistemit të menaxhimit të kontrolleve të brendshme nga auditorët mbi këta artikuj ka shumë të ngjarë të përfshijë:
- Rishikimin e procedurave për të siguruar që vlera e materialeve është e shënuar siç duhet në pasqyrën e pozitës financiare.
 - Rishikimin e formave të blerjes së materialeve për miratime, dhe gjurmimi i formave të lëshimit në regjistrat e përhershëm të inventarit për të verifikuar që inventari është lëshuar me autorizimin e duhur.
 - Vëzhgimin e transaksioneve të inventarit për të konstatuar nëse po ndodhin vjedhje materiale.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

IV. Rishikimin e sistemit të departamentit të prodhimit për krahasimin e përdorimit të këtyre metaleve me standardet.

- a) III dhe IV
- b) I dhe IV**
- c) Vetëm I
- d) II dhe III

15. Ju jeni duke audituar sistemin e pagave të një kompanie. Për të përmbushur një objektiv të auditimit për të konstatuar se nuk bëhet asnjë pagesë për punonjës fiktivë, ju do të:

- a) Kryeni një test të pagese së pagave.**
- b) Kontrolloni kartat e kohës për aprovim nga mbikëqyrësi.
- c) Intervistoni personelin e pagave në lidhje me kontrollet e brendshme mbi përgatitjen e pagave.
- d) Kryeni analizë analitike të kostove të pagave në krahasim me standardet e industrisë.

16. Një auditor i brendshëm ka vendosur ta vizitoj departamentin e prodhimit menjëherë pas mbylljes së vitit fiskal dhe po ekzaminon gjendjen. Çdo opsion i cekur më poshtë përbëhet nga një procedurë specifike e auditimit dhe një zgjedhje e katër gjetjeve të ndryshme të auditimit. Cili nga gabimet ose praktikat e diskutueshme ka shumë të ngjarë të zbulohet nga procedura e auditimit e specifikuar (të cilën auditori po e kryen)?

- a) Mbulimi i sigurimit të objektit ka skaduar.
- b) Kostot shtesë janë mbivlerësuar.
- c) Nuk është kryer mirëmbajtja e nevojshme e objektit.**
- d) Shpenzimet e amortizimit në makineritë plotësisht të amortizuara janë njohur.

17. Nëse një firmë prodhuese ka vendosur një kufi në numrin e defekteve që janë të tolerueshme në montimin përfundimtar të një produktit të saj, cila nga procedurat e mëposhtme të kontrollit të cilësisë duhet të përdoret?

- I. Kontrolloni mallrat e përfunduara për pajtueshmëri me tolerancat e përcaktuara.
- II. Rishikoni kthimet e shitjeve për defektet që nuk janë zbuluar gjatë procesit përfundimtar të inspektimit.
- III. Krahasoni materialet dhe specifikimet e makinerive me modelet origjinale të produkteve.
- IV. Vendosni një rreth cilësor që përfshin menaxhmentin dhe vartësit për të diskutuar efikasitetin e punës.

- a) I, III, dhe IV.
- b) II dhe III.
- c) I, II, dhe III.**
- a) III dhe IV.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

18. Cila nga situatat e mëposhtme do të bënte që një auditor i brendshëm të vinte në dyshim përshtatshmërinë e kontrolleve të brendshme në një funksion blerjeje?
- Originali dhe një kopje e porosisë së blerjes i dërgohen shitësit me postë. Kopja në të cilën shitësi pranon pranimin e porosisë së blerjes i kthehet departamentit të blerjes.
 - Raportet e pranimit dërgohen në departamentin e blerjeve aty ato përputhen me porositë e blerjes dhe dërgohen tek departamenti i llogarive të pagueshme.**
 - Departamenti i llogarive të pagueshme përgatit dokumentacionin për pagesa.
 - Dosjet e faturave të papaguar dhe regjistrat e përhershëm të inventarit mirëmbahen në mënyrë të pavarur.
19. Për të minimizuar humbjet e mundshme financiare të lidhura me pasuritë afatgjata materiale, pasuritë e prekshme duhet të mbulohen nga sigurimi i duhur në një shumë që është:
- Përcaktuar nga bordi i drejtorëve.
 - Rregulluar automatikisht nga indeksi i çmimit të konsumit.
 - Në marrëveshje me bazën për vlerësimet e tatimit në pronë.
 - Mbështetur në vlerësime periodike.**
20. Një rrezik që lidhet me ciklin e blerjes është mundësia që mund të porositen sasi më të mëdha të produkteve sesa që janë nevojat organizative. Cila nga kontrollet e mëposhtme do të adresonte këtë ekspozim?
- Departamenti i blerjes të bëjë të gjitha porositë kur kompjuteri tregon një nivel të ulët të inventarit.
 - Departamenti i pranimit të mallrave që vonon shkarkimin e secilës dërgesë të paraqitur për marrje derisa të jetë në dispozicion një urdhër blerje origjinal.
 - Një mbikëqyrës i departamentit që përdor rishikimin e çdo kërkesë blerjeje përpara se të përcillet në departamentin e blerjes.**
 - Depo vonon magazinimin e të gjitha mallrave derisa departamenti i inspektimit të sigurojë një raport pranimi që është në përputhje me fletën e paketimit të siguruar nga shitësi.
21. Shumica e organizatave janë të shqetësuara për kompromisin e mundshëm të fjalëkalimeve. Cila nga procedurat e mëposhtme do të ishte më efektive në kontrollimin ndaj përdorimit të paautorizuar të fjalëkalimit të dikujt tjetër?
- Lejoni vetëm përdoruesit të ndryshojnë fjalëkalimet e tyre dhe inkurajojini ata të ndryshojnë fjalëkalimet shpesh.
 - Zbatoni një program kompjuterik që teston për të parë që fjalëkalimi nuk është i lehtë për tu qëlluar.
 - Zbatoni përdorimin e teknikave të vërtetimit, me anë të të cilave përdoruesi përdor një çelës për të gjeneruar një fjalëkalim dhe verifikon si çelësin ashtu edhe fjalëkalimin e gjeneruar në sistem.**
 - Kufizoni autorizimin e fjalëkalimit në kohë dhe vendndodhje gjatë një ditë.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

22. Drejtorët mund të përdorin një mjet të quajtur "analiza e rrezikut" në përgatitjen e orareve të punës. Cila nga të mëposhtmet NUK do të konsiderohej gjatë kryerjes së një analize të rrezikut?
- Ekspozimi financiar dhe humbja e mundshme.
 - Aftësitë e disponueshme në stafin e auditimit.**
 - Rezultatet e auditimeve paraprake.
 - Ndryshimet kryesore të operimit.
23. Standardet e IIA kërkojnë që auditorët e brendshëm të diskutojnë mbi konkluzionet dhe rekomandimet në nivelet e duhura të menaxhimit përpara se të lëshojnë raportet përfundimtare të shkruara. Cila nga opsionet e mëposhtme është arsyeja kryesore që një konferencë dalëse duhet të dokumentohet nga auditori?
- Standardet e IIA kërkojnë që konferencat dalëse të dokumentohen.
 - Informacioni mund të jetë i nevojshëm nëse lind një mosmarrëveshje.**
 - Informacioni mund të jetë i nevojshëm për të rishikuar programet e ardhshme të auditimit.
 - Dokumentimi i konferencës dalëse shërben si bazë për auditimet e ardhshme.
24. Qëllimi kryesor i konferencës dalëse është:
- Korrigjimi i mangësive të gjetura.
 - Komunikimi me të gjitha palët e afektuara.**
 - Vlerësimi i performancës së personelit të auditimit.
 - Prezantimi i raportit përfundimtar të auditimit.
25. Një letër pune e dokumentuar në mënyrë adekuate duhet:
- Të ndjek një formë dhe rregullim unik.
 - Të përmbaj shembuj të të gjitha formave dhe procedurave të përdorura nga i audituari.
 - Të jetë e shkurtër por gjithëpërfshirëse.**
 - Të mos përmbajë kopje të shënimeve të auditorit.
26. Gjatë një konference të daljes, një auditor dhe një i audituar nuk ranë dakord për një gjetje të auditimit të dokumentuar mirë. Cila nga opsionet e mëposhtme do të përshkruante një mënyrë të përshtatshme për të trajtuar situatën, duke supozuar që ajo nuk mund të zgjidhet para lëshimit të raportit të auditimit?
- Paraqitni gjetjen duke dhënë të gjitha faktet dhe konkluzionet që rezultojnë nga testimi.
 - Paraqitni gjetjen e auditimit si dhe pozicionin e të audituarit për gjetjen.**
 - Shtyni raportimin e gjetjes dhe planifikoni të kryeni punë më të hollësishme gjatë auditimit të ardhshëm.
 - Ndryshoni rezultatet për t'u pajtuar me pozicionin e të audituarit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

27. Qëllimi i konferencës së daljes është që auditori i brendshëm të:

- a) Kërkoj veprime korrigjuese për mangësitë e gjetura.
- b) Rishikoj dhe verifikoj përshtatshmërinë e raportit të auditimit bazuar në kontributin e të audituarit.**
- c) Rishikoj performancën e personelit të auditimit të caktuar në angazhim.
- d) Paraqes menaxhmentit raportin përfundimtar të auditimit.

28. Në cilën pjesë të raportit përfundimtar, auditori i brendshëm duhet ti përshkruajë objektivat e auditimit?

- a) Fushëveprimi
- b) Kriteret
- c) Kushtet
- d) Qëllimi**

29. Një auditor i brendshëm në një kompani të shitjeve me pakicë i raporton drejtorit të auditimit të brendshëm të korporatës. Auditori është caktuar të kontrollojë një departament rajonal. Raportet e auditimit duhet të dërgohen në zyrën e korporatës dhe kontrolluesin e departamentit në rajon. Auditori ka qenë në vendndodhje për gjashtë muaj dhe ka paraqitur raporte mujore, çdo muaj duke audituar një pjesë të operacionit siç është caktuar nga auditimi i brendshëm i korporatave. Këtë muaj, për herë të parë, auditori ka audituar kontrollat e stokeve, duke ndjekur procedurat e vendosura nga stafi i auditimit të brendshëm të korporatës.

Pasi pa raportin e auditimit për kontrollin e stokeve, kontrolluesi i departamentit thirri dhe kërkoi një takim me auditorin. Në takim, kontrolluesi i departamentit kritikoi me zë të lartë dhe abuzivisht punën e auditorit, qëndrueshmërinë e metodave të auditorit dhe rezultatet e paraqitura në raporte. Në të kaluarën, ndërsa jo gjithnjë duke rënë dakord me përfundimet e auditorit, kontrolluesi i departamentit gjithmonë kishte diskutime racionale dhe zhvilloi hapa të duhur përcjellës për të korrigjuar problemet që auditori gjeti.

Ky auditim i veçantë nuk ishte puna më e mirë e auditorit, dhe auditori e kupton këtë. Auditori duhet të:

- a) mbroj punën tani dhe të përpiqet ta përmirësoni atë në të ardhmen.
- b) shpjegoj problemet personale që e kufizuan auditorin të punojë në këtë raport ashtu siç pritej.
- c) kërkoj nga kontrolluesi i departamentit të identifikojë fushat specifike në të cilat raporti është i mangët, dhe nëse kundërshtimet janë të justifikuara, të rishikoj raportin.**
- d) kërkoj kohë pushimi për t'u trajnuar në fushat më të dobëta.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

30. Pasi u emërua, një drejtor i ri i auditimit të brendshëm gjeti një staf auditimi të papërvojë i cili ishte mbi buxhetuar për shumicën e auditimeve. Një përmbledhje e detajuar e letrave të punës të auditimit nuk zbuloi evidenca të rishikimeve progresive nga mbikëqyrësit e auditimit. Për më tepër, nuk ka evidencë që ekzistonte një program i sigurimit të cilësisë. Për të vlerësuar si duhet operacionet e një departamenti të auditimit të brendshëm, një program i sigurimit të cilësisë duhet të përfshijë:
- Mbikëqyrja periodike e punës së auditimit të brendshëm mbi bazën e mostrës.
 - Shqyrtime të jashtme të paktën një herë në tre vjet nga persona të kualifikuar që janë të pavarur nga organizata.**
 - Shqyrtime të brendshme, përveç personelit të auditimit të brendshëm, për të vlerësuar cilësinë e operacioneve të departamentit.
 - Rotacioni periodik i menaxherëve të auditimit.
31. Cila nga aplikacionet e mëposhtëm mikrokompjuterike do të ishte shumë pak i dobishëm në përgatitjen e letrave të punës së auditimit?
- Softueri i fletëllogaritjes.
 - Softuer për përpunimin e fjalëve.
 - Softueri i shërbimeve.**
 - Softueri i bazës së të dhënave.
32. Cila nga deklaratat e mëposhtme në lidhje me mbajtjen e letrave të punës së auditimit paraqet një politikë të papërshtatshme?
- Dokumentet e punës duhet të hudhen kur ato nuk kanë përdorim të mëtejshëm.
 - Dokumentet e punës për auditimet e mashtrimeve duhet të mbahen për një kohë të pacaktuar.**
 - Këshilltari ligjor duhet të miratojë kohëzgjatjen e mbajtjes së letrës së punës.
 - Kohëzgjatja e mbajtjes së dokumenteve të punës duhet të marr parasysh kërkesat ligjore dhe kontraktuale.
33. Një auditor i brendshëm në një kompani të shitjeve me pakicë raporton tek drejtori i auditimit të brendshëm të korporatës. Auditori është caktuar të auditojë një divizion rajonal. Raportet e auditimit duhet të dërgohen në zyrën e korporatës si dhe tek kontrollori i divizionit rajonal. Auditori ka qenë në vendndodhje për gjashtë muaj dhe ka dorëzuar raporte mujore, çdo muaj duke kontrolluar një pjesë të operacionit siç është caktuar nga auditimi i brendshëm i korporatës. Këtë muaj, për herë të parë, auditori ka audituar kontrollet e inventarit, duke ndjekur procedurat e vendosura nga stafi i auditimit të brendshëm të korporatës. Pasi pa raportin e auditimit mbi kontrollin e inventarit, kontrollori i divizionit thirri dhe kërkoi një takim me auditorin. Në takim, kontrollori i divizionit kritikoi me zë të lartë dhe në mënyrë abuzive saktësinë e punës së auditorit, qëndrueshmërinë e metodave të auditorit dhe rezultatet e paraqitura në raporte. Në të kaluarën, megjithëse nuk ishte gjithmonë dakord me konkluzionet e auditorit, kontrollori i divizionit gjithmonë kishte diskutime racionale dhe zhvilloi hapat e duhur vijues për të korrigjuar problemet që auditori gjente.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

Pavarësisht se kurrë nuk e kishte thënë kështu, kontrollori i divizionit gjithmonë kishte menduar që puna e auditorit ishte nën standard. Kontrolluesi i divizionit mund ta ketë trajtuar më mirë situatën duke:

- a) Sigurimi i trajnimit për auditimin e kontrolleve të inventarit në mënyrë që auditori të bëjë një punë më të mirë herën tjetër.
- b) Dokumentimi i mangësive rregullisht dhe raportimi i tyre te drejtori i auditimit të brendshëm.**
- c) Diskutimi i punës së auditorit me auditorë të tjerë të brendshëm për të krahasuar metodat e auditorit me të tjerët të përdorur në kompani.
- d) Thirrja e drejtorit të auditimit të brendshëm të korporatës dhe insistimi që auditori të zëvendësohet.

34. Hetimi i krimeve të kryera me kompjuter përmban në vetvete çështje shumë teknike, gjë që e bën të domosdoshme që gjatë kontrolleve të ndërmerren hapat e duhur për të bërë të sigurt edhe trajtimin e duhur edhe ruajtjen e evidencave. Cila nga opsionet e mëposhtme përfshinë të gjitha elemente që duhet të merren në konsideratë për sa i takon kujdesit dhe trajtimit të evidencave:

- a) Zbulimi dhe njohja; Regjistrimi; Mbledhja; Identifikimi; Ruajtja; Transportimi
- b) Zbulimi dhe njohja; Mbrojtja; Regjistrimi; Mbledhja; Ruajtja; Transportimi
- c) Zbulimi dhe njohja; Mbrojtja; Regjistrimi; Mbledhja; Identifikimi; Ruajtja; Transportimi**
- d) Zbulimi dhe njohja; Regjistrimi; Mbledhja; Identifikimi; Ruajtja.

35. Super shkatërrimi (ang. SuperZapping), është një shembull i një sulmi të biznesit i cili përfshin:

- a) mbledhjen e informacioneve të kartave të kreditit të klientëve nëpërmjet faqeve të internetit dhe përdorimi i pa - autorizuar i transfereve të fondeve në llogaritë personale që ndodhen në një institucion financiar.
- b) ndryshimin e të dhënave para ose gjatë futjes në kompjuter ose gjatë përfutimit të rezultateve (outputeve) nga sistemi kompjuterik.
- c) përdorimin e pa - autorizuar të një programi kompjuterik për shërbime (ang. utility program) për të modifikuar, shkatërruar, kopjuar, publikuar, futur, përdorur, ose mos lejuar përdorimin e të dhënave të ruajtura në një sistem kompjuterik ose në një media kompjuterike.**
- d) shkatërrimin e harduerëve ose objekteve.

36. Një raport i auditimit operativ që merret me funksionin e hedhjes së mbeturinave në një kompani prodhuese duhet të adresojë:

- a) Efikasiteti dhe efektiviteti i funksionit të hedhjes së mbetjeve dhe të përfshijë çdo gjë që kërkon veprim korigjues.**
- b) Nëse inventari i materialit për hedhje raportohet si një pasuri qarkulluese.
- c) Nëse llogaritja e inventarit fizik të materialit për hedhje është në përputhje me shumën e regjistruar.
- d) Nëse inventari i materialit për hedhje vlerësohet në koston më të ulët ose në vlerën e tregut.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

37. Cili nga individët e mëposhtëm normalisht NUK do të merrte një raport të auditimit të brendshëm në lidhje me një rishikim të ciklit të blerjes?
- a) Drejtori i blerjes.
 - b) Auditori i jashtëm i pavarur.
 - c) Auditori i përgjithshëm.
 - d) Kryetari i bordit të drejtorëve.**
38. Po lëshohet një raport i auditimit me gjetjet e zakonshme për departamentin e llogarive të pagueshme. Shpërndarja e raportit duhet të përfshijë mbikëqyrësin e llogarive të pagueshme, menaxherin dhe menaxherin e përgjithshëm të njësisë. Raporti mund të dërgohet gjithashtu tek:
- a) Audituesit e jashtëm dhe kontrolluesi i korporatës.**
 - b) Menaxheri i blerjeve dhe drejtori i operacioneve.
 - c) Menaxheri i marrjes së porosive, menaxheri i blerjes dhe drejtori i operacioneve.
 - d) Audituesit e jashtëm, kontrollori i korporatës dhe kryetari i bordit të drejtorëve.
39. Për shkak të dobësive të kontrollit, është e mundur që menaxherët individualë të 122 restoranteve mund të kenë vendosur punonjës fiktivë në listën e pagave. Çdo restorant punëson 25-30 persona. Për të përcaktuar në mënyrë efikase nëse ky mashtrim ekziston në më pak se 1%, auditori duhet të përdorë:
- a) Mostrën sipas veçorive.
 - b) Mostrën sipas gjykimit.
 - c) Mostrën sipas drejtimit.
 - d) Mostrën për zbulim**
40. Drejtori i auditimit të brendshëm të një kompanie shumëkombëshe duhet të formojë një ekip auditimi për të ekzaminuar një filial të sapo mblerë në një vend tjetër. Cilët nga faktorët e mëposhtëm duhet pasur parasysh?
- I. Zakonet lokale.
 - II. Aftësitë gjuhësore të auditorit.
 - III. Përvoja e auditorit.
 - IV. Kursi monetar i këmbimit.
- a) I, II dhe III**
 - b) II, III dhe IV
 - c) I dhe III
 - d) I dhe II

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

41. Nëse stafi i auditimit të brendshëm nuk ka aftësi për të kryer një detyrë të veçantë, mund të sillet një specialist nga:
- Firma e auditimit të jashtëm të organizatës.
 - Një firmë e jashtme këshilluese.
 - Departamenti që aktualisht po auditohet.
 - Një koleg apo universitet.
- I dhe II
 - II dhe IV
 - I, II dhe III
 - I, II dhe IV**
42. Pse duhet që kompanitë të kërkojnë nga palët e audituara të përgjigjen menjëherë dhe përshkruajnë veprimet korigjuese që janë zbatuar për mangësitë e raportuara?
- Për të mbyllur sa më shpejt çështjet e hapura të auditimit.
 - Për të realizuar kursimet sa më shpejt që të jetë e mundur.**
 - Për të treguar përputhjen me gjetjet e auditimit.
 - Për të siguruar që performanca e auditorit është vlerësuar.
43. Cila nga pohimet e mëposhtme është e saktë lidhur me procedurat analitike:
- Procedurat analitike janë procedura të pavarura të auditimit të cilat orientohen ndaj zbulimit, të mashtrimeve të bëra nga ana e menaxhmentit.**
 - Procedurat analitike janë procedura të pavarura të auditimit të cilat orientohen ndaj parandalimit, të mashtrimeve të bëra nga ana e menaxhmentit.
 - Procedurat analitike janë procedura të pavarura të auditimit të cilat orientohen ndaj parashikimit të mashtrimeve që mund të bëhen nga ana e menaxhmentit.
 - Procedurat analitike janë procedura të pavarura të auditimit të cilat orientohen ndaj parashikimit dhe parandalimit, të mashtrimeve të bëra nga ana e menaxhmentit.**
44. Mjeti më i mirë për departamentin e auditimit të brendshëm për të përcaktuar nëse qëllimi i tij për të zbatuar një auditim më gjithëpërfshirës të aktiviteteve funksionale është përmbushur është përmes:
- Grumbullimit të gjetjeve të auditimit sipas zonës së auditueshme.
 - Krahasimit të planit të auditimit me aktivitetin aktual të auditimit.**
 - Sondazhet e kënaqësisë së menaxhmentit me funksionin e auditimit të brendshëm.
 - Zbatimi i një programi të sigurimit të cilësisë.
45. Bëra e sigurt se të gjithë punonjësit kanë të njëjtin vizion si edhe kompania është shembull i kontrolleve:
- Parandaluese**
 - Zbuluese
 - Rimëkëmbjes
 - Parandaluese dhe Zbuluese

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

46. Në rastet kur dyshohet që në regjistrat kontabël janë bërë nën-vlerësime të vlerave monetare një auditor zakonisht duhet të filloj auditimi nga:
- a) Dokumentet burimore dhe të ecni përpara për të arritur tek pasqyrat financiare**
 - b) Pasqyrat financiare dhe të ecni prapsht për të arritur tek dokumentet burimore
 - c) Analizimi i të dhënave të viteve të kaluara
 - d) Analizimin e numrit dhe natyrës së transaksioneve të veçanta që janë trajtuar.
47. Një memorandum i intervistës me një dëshmitar duhet të përmbajë cilat nga këto elemente:
- a) Natyra e intervistës, Data e kryerjes së intervistës, Identiteti i intervistuesit
 - b) Natyra e pyetjeve të bëra, Data e kryerjes së intervistës, Metoda e kryerjes së intervistës
 - c) Natyra e intervistës, Data e kryerjes së intervistës, Metoda e kryerjes së intervistës.
 - d) Natyra e pyetjeve të bëra, Natyra e intervistës, Data e kryerjes së intervistës, Metoda e kryerjes së intervistës, Identiteti i intervistuesit**
48. Cilat janë karakteristikat e një raporti të mirë hartuar mbi mashtrimet:
- a) Saktësia, Qartësia, Paanësia.
 - b) Saktësia, Qartësia, Paanësia, Domethënia, në kohë.**
 - c) Saktësia, Qartësia, Paanësia, në kohë.
 - d) Qartësia, Paanësia, në kohë.
49. Analiza e prirjeve si një lloj i procedurave analitike shqyrton cilën nga opsionet e më poshtme:
- a) procedurat që përfshijnë analizën e njëkohshme të dy ose më shumë llogarive të pasqyrave financiare.
 - b) lidhjen e supozuar të konsistencës midis llogarive
 - c) marrëdhëniet e rëndësishme dhe konsistente midis të dhënave financiare dhe atyre operacionale.
 - d) tendencat e tepricave të llogarive si një bazë për të përcaktuar nëse ka apo jo mundësi që të dhënat e periudhës aktuale të përmbajnë anomali**
50. Auditimi investigues ndahet në katër faza. Cila nga se vijon paraqet renditjen e duhur të fazave të auditimit investigues ?
- a) Mbledhja e evidencave; vlerësimi i evidencave; njohja e problemeve dhe planifikimi; komunikimi i rezultateve.
 - b) Vlerësimi i evidencave; njohja e problemeve dhe planifikimi; mbledhja e evidencave; komunikimi i rezultateve.
 - c) Komunikimi i rezultateve; njohja e problemeve dhe planifikimi; mbledhja e evidencave; vlerësimi i evidencave.
 - d) Njohja e problemeve dhe planifikimi; mbledhja e evidencave; vlerësimi i evidencave; komunikimi i rezultateve.**